



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**INSPEKTORATI SHTETËROR
I PUNËS DHE SHËRBIMEVE
SHOQËRORE**

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**

Nr. 1040 Prot.
Tiranë, më 29/06/2023

Nr. 13844 Prot.
Tiranë, më 29/6/2023

MARRËVESHJE

PËR

BASHKËPUNIM DHE SHKËMBIM INFORMACIONI

NDËRMJET

INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE

SHOQËRORE

DHE

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Tiranë, më 29/06/2023

BIEN DAKORD:

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, referuar më tutje si “Palët”.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (në vijim ISHPSHSH) është një institucion që vepron në bazë dhe zbatim të ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 121/2016, datë 24.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM 295, datë 20.03.2013 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHPSHSH-së” dhe ka për mision kontrollin, konstatimin, këshillimin, njoftimin, formimin, zbutjen e konflikteve, parandalimin dhe sanksionimin, si dhe garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe të atij të shërbimeve shoqërore.

Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim QKB) është institucion i administratës shtetërore dhe vepron në bazë dhe zbatim të ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. QKB-ja funksionon si një qendër e vetme me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit, si dhe regjistrimit të pronarëve përfitues, duke sjellë një reduktim të mëtejshëm të barrierave administrative për bizneset që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Misioni i QKB-së është ofrimi i shërbimeve të saj elektronikisht nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania me procedura të thjeshta, brenda afateve kohore të shkurtra dhe pa asnjë kosto për biznesin.

Neni 1

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është:

1. Dërgimi i informacionit i cili lidhet me punën e ISHPSHSH ku krahas kompetencës për zhvillimin e kontrollit të subjekteve në terren, me qëllim sigurimin e zbatimit të dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohezgjatjen e punës, pagat, punësimitin e grave, fëmijëve nën 18 vjeç etj, ngarkohet edhe për dhënien e këshillave teknike punëdhënësve dhe punëmarrësve, duke i informuar mbi rregulloret dhe zbatimin e legjislacionin në fuqi. Në këtë këndvështrim për t’u ardhur në ndihmë subjekteve të reja, me dhënien e informimit në lidhje me të drejtat dhe detyrimet ligjore, që ka çdo punëdhënës, në lidhje me marrëdhëniet dhe kushtet e punës, që në muajin e parë të hapjes së biznesit është e nevojshme dhënia e informacionit nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit, të cilat shërbejnë për inspektimin nga ana e ISHPSHSH.
2. Informacioni i dërguar nga Qendra Kombëtare e Biznesit përmban të dhëna si: (NIPT/NUIS i subjektit, emrin e subjektit, llojin e pronësisë, data e regjistrimit, vendi i

ushtrimit të aktivitetit, lloji i shoqërisë, numri i telefonit, adresa e-mail, statusi i subjektit, objekti i veprimtarisë, administratori dhe lloji i aktivitetit) për të gjitha shoqëritë e reja, të riaktivizuara, të pezulluara dhe çregjistruara pranë Regjistrat Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 2

BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje është e bazuar në zbatim të Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 121/2016, datë 24.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM 295, datë 20.03.2013 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHPSHSH-së”, Ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Neni 3

PARIMET E MARRËVESHJES

Bashkëpunimi i palëve në kuadër të përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

1. Përcaktimet e kësaj marrëveshje nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore mbi bazë dhe për zbatim të së cilave lidhet kjo marrëveshje;
2. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje nuk mund të çenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit këto institucione janë krijuar dhe funksionojnë;
3. Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi do të bëhet vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat në fuqi që rregullojnë kuadrin ligjor të funksionimit të dy institucioneve;
4. Shkëmbimi i informacionit kryhet, në bashkërendim me ligjet respektive ose kërkesat rregullatore. Informacioni i kërkuar nuk plotësohet kur:
 - i. është në kundërshtim me ndonjë ligj apo akt që rregullon ruajtjen e konfidencialitetit;
 - ii. nuk është bërë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë marrëveshje;

Neni 4

PROCEDURA PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT

1. Në përputhje me ligjin, QKB do të dërgojë informacionin që disponon, i cili lidhet me përcaktimet e nenit 1 të kësaj marrëveshje bashkëpunimi dhe do t'i vendoset në dispozicion ISHPSHSH, çdo datë 15 të muajit pasardhës, në formë tabelare (excel) sipas modelit në **ANEKS I** bashkëlidhur, nga adresa zyrtare e e-mailit të personit të kontaktit, përcaktuar në nenin 5 të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
2. Informacioni i dërguar nga QKB është konfidencial dhe nuk do t'i shpërndahen palëve të treta, pa miratimin paraprak me shkrim të palëve në këtë marrëveshje bashkëpunimi, përveçse kur në ligj parashikohet ndryshe.
3. ISHPSHSH nuk do të lejojë përdorimin apo dhënien e informacionit të marrë nga QKB-ja për qëllime të tjera nga ato të përmendura në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
4. Për të lehtësuar komunikimin dhe për të siguruar vazhdimësinë e bashkëpunimit ndërmjet palëve, çdo palë cakton personin e kontaktit, për komunikimet sipas kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 5

PERSONAT E KONTAKTIT

Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit sipas kësaj marrëveshje, palët përcaktojnë personat e kontaktit, dhe të gjitha komunikimet ndërmjet palëve do të realizohen nëpërmjet tyre, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe.

Personat e kontaktit sipas palëve do të jenë si më poshtë:

ISHPSHSH – përfaqësohet nga Dorina Hysa, me pozicion Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit në Punë, adresë e-mail (Dorina.Hysa@sl.gov.al) dhe Nr. Kontakti +355 69 872 7072.

QKB – përfaqësohet nga Geljada Llupo, me pozicion Specialist në Drejtorinë e Regjistrave dhe Analizës, me adresë e-mail (Geljada.Llupo@qkb.gov.al) dhe Nr. Kontakti +355 69 260 8854.

Neni 6

KOSTOT FINANCIARE

Në rastet kur përmbushja e kërkesave të kësaj marrëveshje kërkon kosto financiare, palët do të angazhohen për marrjen përsipër të tyre respektivisht, në përputhje me rregullat e tyre institucionale.

Neni 7

SHQYRTIMI I MARRËVESHJES

Institucionet nënshkruese rishikojnë vazhdimisht zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi dhe konsultojnë atë me synimin e përmirësimit dhe të zgjidhjes së problemeve të ndryshme që mund të dalin.

Neni 8
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ngarkohen ISHPSHSH dhe QKB me strukturat e tyre përbërëse për zbatimin e detyrave të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.
2. Çdo rregullim ose ndryshim, i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, bëhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve dhe me shkrim.
3. Palët duhet t'i përgjigjen propozimeve reciproke për rregullime ose ndryshime, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së këtij propozimi.
4. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
5. Marrëveshja mund të përfundojë me njoftimin me shkrim të secilës palë, një muaj pas këtij njoftimi.

Neni 9
PUBLIKIMI

Palët bien dakort që kjo marrëveshje bashkëpunimi do të publikohet në faqet zyrtare të secilës palë.

Neni 10
HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të jetë në fuqi për një periudhë kohe të pacaktuar.

Kjo marrëveshje hartohet në katër kopje dhe secila nga palët mban dy kopje në origjinal.

Kjo marrëveshje përbëhet nga 10 (dhjetë) nene, 6 (gjashtë) faqe.

Nënshkruar sot, më datë 29/06/2023, në Tiranë.

INSPEKTORATI SHTETËROR
I PUNËS DHE SHËRBIMEVE
SHOQËRORE

KRYEINSPEKTORI

Eljo MUÇAJ



QENDRA KOMBËTARE E
BIZNESIT

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Iris AGO

